

LËVIZJA EUROPIANE NË SHQIPËRI

Paditë strategjike kundër
pjesëmarrjes publike (SLAPP) –
Sfidat e përafrimit të legjislacionit

Dr. Aida Bushati



PUBLIKUES

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
Rr. Milto Tutulani, Nd.1, Ap. 3
Tirana 1019, Albania
Tel: +355 44 104 247
E-mail: info@em-al.org
Web: www.em-al.org

AUTORE:

Dr. Aida Bushati

VITI I PUBLIKIMIT:

qershor, 2026

Ky material është prodhuar në kuadër të projektit “Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Lëvizjes Europiane në Shqipëri dhe autorëve, dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Projekti "Ndërtimi i Partneritetit mbi Çështjet Themelore: Fuqizimi i OSHC-ve për procesin e anëtarësimit në BE", po zbatohet nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian - IPA Civil Society Facility and Media 2021, në bashkëpunim me Akademinë e Integritimit Evropian dhe Negociatave (AIEN), Slovak Foreign Policy Association (SFPA) dhe Qendrën për Transparencë dhe Informim të Lirë (CTFI)



Hyrje	03
<hr/>	
Paditë SLAPP - Kuptimi	04
<hr/>	
Kuadri ligjor europian – paditë SLAPP	04
3.1. Liria e shprehjes si e drejtë themelore	04
3.2. Direktiva Anti-SLAPP	05
3.3. Këshilli i Europës dhe paditë SLAPP	06
3.4 Sfidat e transpozimit të Direktivës SLAPP në Shtetet Anëtare të BE-së	07
<hr/>	
Transpozimi i Direktivës dhe Rekomandimeve të KiE	09
4.1 Kuadri normativ ekzistues dhe boshllëqet	09
4.2. Rrugët e mundshme të transpozimit dhe kriteret e një ligji efektiv	11
<hr/>	
Përfundime dhe Rekomandime	12
<hr/>	
Bibliografia	14
<hr/>	

Liria e shprehjes dhe aktivizmi publik përbëjnë shtylla themelore të një shoqërie demokratike dhe të funksionimit efektiv të ndarjes së pushteteve. Në çdo demokraci, mundësia e qytetarëve, gazetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile për të shprehur lirisht mendimet e tyre, për të kritikuar vendimmarrjen e autoriteteve publike dhe për të kontribuar në debatin mbi çështje me interes publik është parakusht për transparencën, llogaridhënien dhe kontrollin demokratik të institucioneve. Kjo e drejtë gëzon mbrojtje të posaçme kushtetuese dhe ndërkombëtare; Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar prej kohësh se liria e shprehjes mbron jo vetëm qëndrimet pozitive, por edhe ato që kritikojnë, dhe se kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë ndaj bartësve të pushtetit publik [1]. Megjithatë, ndaj ushtrimit të kësaj të drejte përdoren shpesh forma të ndryshme frenimi dhe presioni, që variojnë nga intimidimi publik dhe presioni ekonomik deri te përdorimi instrumental i mekanizmave ligjorë.

Një prej formave të intimidimit janë Paditë Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (Strategic Lawsuits Against Public Participation – SLAPP)[2], të cilat synojnë të frikësojnë ose të rëndojnë financiarisht individë dhe organizata që ushtrojnë të drejtën e tyre të shprehjes mbi çështje me interes publik. Këto padi iniciohen nga persona me pushtet kundër personave dhe ngjarjeve me interes publik. Tipari dallues i tyre nuk është thelbi i pretendimit, por qëllimi që synojnë të arrijnë[3]. Në këtë mënyrë, paditë SLAPP përbëjnë kërcënim jo vetëm për individët e targetuar, por edhe për vetë cilësinë e demokracisë dhe pluralizmin e debatit publik. Veçanërisht paditë SLAPP të ngritura kundër gazetarëve kanë funksionuar jo si mjete të vërteta për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve juridike, por si instrumente intimidimi që synojnë të dobësojnë funksionin kontrollues ndaj pushtetit, një dukuri që mori vëmendje në Europë sidomos pas vrasjes së gazetares investigative malteze Daphne Caruana Galizia përballëj me rreth 50 padi aktive për shpifje. [4]

Pikërisht ky ndërgjegjësim ka prodhuar gjatë viteve të fundit një arkitekturë normative europiane kundër abuzimit gjyqësor me lirinë e shprehjes. Paditë SLAPP u identifikuan fillimisht si një fenomen i veçantë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë viteve '70.[5] Në nivel të Bashkimit Europian, kjo arkitekturë u konkretizua me Direktivën (BE) 2024/1069, e cila parashikon mekanizma dhe mbrojtje nga vendimet gjyqësore abuzive.[6] Paralelisht, Këshilli i Europës miratoi Rekomandimin CM/Rec(2024)2, i cili ndonëse jo detyrues u kërkon shteteve anëtare të ndërtojnë strategji gjithëpërfshirëse kundër SLAPP-ve, duke përfshirë jo vetëm fushën civile, por edhe atë administrative e penale.[7] Kjo kornizë e dyfishtë nuk i adresohet vetëm shteteve anëtare; ajo përcakton standarde që vendet kandidatë pritet t'i përafrojnë gjatë procesit të integritimit, duke e shndërruar mbrojtjen kundër SLAPP-ve në një tregues konkret të pjekurisë demokratike dhe të shtetit të së drejtës.

Shqipëria nuk qëndron jashtë këtyre dinamikave. Si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, ajo është e angazhuar të harmonizojë rendin e saj juridik me *acquis*-në e BE-së, përfshirë instrumentet që mbrojnë lirinë e shprehjes dhe pjesëmarrjen publike nga abuzimi gjyqësor. Por pikërisht statusi i saj si vend ende jashtë BE-së e vendos përpara një sërë sfidash të veçanta lidhur me transpozimin formal të këtyre akteve dhe, mbi të gjitha, me zbatimin e tyre në praktikën gjyqësore. [8] Pikërisht këto sfida, mënyra se si standardet europiane mund dhe duhet të bëhen pjesë funksionale e së drejtës shqiptare përbëjnë thelbin e analizës që paraqitet në vijim.

Paditë SLAPP - Kuptimi

Paditë SLAPP përfaqësojnë një formë të keqpërdorimit të të drejtave procedurale qofshin këto penale apo civile, pasi synojnë jo zgjidhjen e një konflikti juridik legjitim, por frenimin e ushtrimit të lirisë së shprehjes për çështje me interes publik [9] dhe dekurajimin e ushtrimit të të drejtave që lidhen me pjesëmarrjen publike. [10]

Në thelb, paditë SLAPP janë zakonisht të pabazuara ose haptazi disproporcionale dhe përdoren për të intimiduar, censuruar, frikësuar ose ngarkuar financiarisht dhe psikologjikisht individët që shprehin mendime kritike ose publikojnë informacion me interes publik. Ato iniciohen kryesisht nga aktorë me pushtet ekonomik, politik ose institucional, si korporata, grupe interesi, zyrtarë publikë apo institucione shtetërore, kundër gazetarëve, aktivistëve, mbrojtësve të të drejtave të njeriut ose individëve të tjerë të përfshirë në debatin publik.

Këto padi shfaqen kryesisht në procese gjyqësore, si padi të drejtpërdrejta ose kundërpadi, shpesh të bazuara në pretendime për shpifje ose cenim reputacioni nga ana e iniciuesit. Identifikimi i një padie SLAPP nuk varet nga vlerësimi subjektiv i qëllimit të paditësit, por nga efekti objektiv që procedura gjyqësore prodhon mbi ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjen publike, duke krijuar një efekt dekurajues.

Kuadri ligjor european – paditë SLAPP

3.1. Liria e shprehjes si e drejtë themelore

Neni 10 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) parashikon se: "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë". [11] Jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e ka zgjeruar ndjeshëm përmbajtjen e këtij neni, duke theksuar vazhdimisht rëndësinë e debatit publik dhe rolin e medias si "watchdog" i demokracisë.[12] Në çështjen Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ-ja theksoi se liria e shprehjes mbrohet jo vetëm për informacionet apo idetë që pranohen ose konsiderohen të padëmshme, por edhe për ato që "ofendojnë, trondisin ose shqetësojnë shtetin ose një pjesë të popullsisë", duke e konsideruar këtë si kërkesë të pluralizmit dhe të tolerancës në një shoqëri demokratike.[13] Më tej, në çështjen Lingens k. Austrisë, Gjykata vendosi se kufijtë e kritikës së pranueshme janë më të gjerë ndaj politikanëve sesa ndaj individëve privatë, pasi figurat publike ekspozohen në mënyrë të vetëdijshme ndaj kontrollit publik. [14]

Një formulim shumë i ngjashëm i së njëjtës të drejtë gjendet edhe në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian (KDTHBE), konkretisht në nenin 11, [15] i cili përcakton se: "Liria e shprehjes përfshin lirinë për të pasur mendime dhe për të marrë e për të përhapur informacione dhe ide pa ndërhyrje nga autoritetet publike dhe pavarësisht kufijve".

Jurisprudenca e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian (GJDBE) ka kontribuar gjithashtu në mbrojtjen e kësaj të drejte. Në çështjen Google Spain SL k. Agencia Española de Protección de Datos (C-131/12), GJDBE-ja trajtoi balancën ndërmjet lirisë së informacionit dhe të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, duke njohur të ashtuquajturën "e drejtë për t'u harruar". [16] Ndërsa në çështjen Glawischnig-Piesczek k. Facebook Ireland (C-18/18), GJDBE analizoi kufijtë e përgjegjësisë së platformave online për përmbajtjet shpifëse dhe heqjen e tyre, duke reflektuar tensionin midis mbrojtjes së reputacionit dhe lirisë së shprehjes në hapësirën dixhitale.[17]

Ajo çka është me e rëndësishme në kuadër të mbrojtjes së lirisë së shprehjes është njohja nga ana e gjykatave europiane të fenomenit të padive SLAPP. Hapi i parë në këtë drejtim u ndërmorr nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen OOO Memo k. Ruisë, [18] e cila shënon rastin e parë që Gjykata i referohet drejtpërdrejt nocionit të padive SLAPP. Çështja kishte të bënte me një padi civile për shpifje të ngritur nga Administrata e Rajonit të Volgogradit kundër shoqërisë mediatike që zotëronte portalin online Kavkazskiy Uzel. Gjykatat vendase kishin detyruar kompaninë të publikonte një përgënjeshtim. GEDNJ-ja vlerësoi se, ndonëse procedurat civile për shpifje u njihen kompanive private ose publike për të mbrojtur reputacionin e tyre, kjo nuk mund të aplikohet për një organ ekzekutiv të financuar nga taksapaguesit, duke konkluduar se ndërhyrja nuk ndiqte një "qëllim legjitim" sipas nenit 10 të KEDNJ-së. Duke iu referuar ndërgjegjësimit në rritje mbi rreziqet që sjellin për demokracinë procedurat gjyqësore të nisura me synimin për të kufizuar pjesëmarrjen publike,

GJEDNJ-ja theksoi efektin frenues (chilling effect) që këto padi ushtrojnë mbi median në rolin e saj si "watchdog" publik.

Po kështu edhe pse trajtuar nga një konkest tjetër GJDBE, në çështjen Real Madrid Club de Fútbol k. Le Monde [19], vlerësoi se ekzekutimi i një vendimi që detyron një botues gazete dhe gazetarin e tij të paguajnë dëmshpërblim duhet të refuzohet nëse do të çonte në një cenim të hapur të lirisë së shtypit të garantuar nga neni 11 i KDTHE-së. Çështja kishte të bënte me publikimin e një artikulli që e lidhte klubin me një skandal doping. Gjykatat spanjolle e detyruan gazetën franceze Le Monde dhe gazetarin e saj t'i paguanin klubit një dëmshpërblim të konsiderueshëm. Kur klubi kërkoi ekzekutimin e këtij vendimi në Francë në bazë të Rregullores "Bruksel I" [20], GJDBE u shpreh se dëmshpërblimet joproporcionale që kanë efekt frenues mbi lirinë e shtypit mund të përbëjnë një cenim të rendit publik, i cili justifikon refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi të dhënë në një shtet tjetër anëtar.

3.2. Direktiva Anti-SLAPP

Miratimi i Direktivës Anti-SLAPP (BE) 2024/1069 [21] përfaqëson kulmin e përpjekjeve të Bashkimit Europian për të adresuar fenomenin në rritje të padive SLAPP, të cilat përdoren për të ushtruar presion financiar dhe psikologjik mbi gazetarët, aktivistët dhe zërat kritikë në çështje me interes publik.

Direktiva Anti-SLAPP, i përkufizon këto padi si "padi ligjore kundër veprimit publik" dhe synon të vendosë një kuadër mbrojtës procedural ndaj këtyre llojeve të padive abuzive.

Kjo Direktivë zbatohet për paditë qartësisht të pabazuara ose procedurat gjyqësore abuzive në çështje civile me implikime ndërkufitare, të ngritura kundër personave fizikë ose juridikë për shkak të angazhimit të tyre në pjesëmarrje publike. [22] Për shkak të kriterit të “implikimeve ndërkufitare”, paditë që lidhen ekskluzivisht me raste të brendshme nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Direktivës. Direktiva përcakton, në mënyrë të përgjithshme duke i lënë hapësirë interpretimit gjyqësor, tre koncepteve kyçe;

- Pjesëmarrja publike, e cila përfshin çdo deklaratë ose aktivitet të kryer nga një person fizik ose juridik në ushtrimin e të drejtës së lirisë së shprehjes dhe informacionit.
- Interesi publik, i cili nënkupton çdo çështje që prek publikun në një masë të tillë sa ky i fundit mund të shfaqë në mënyrë legjitime interes për të.
- Procedura abuzive, e cila i referohet atyre procedurave gjyqësore që nuk synojnë realisht pohimin apo ushtrimin e një të drejte, por kanë si qëllim kryesor parandalimin, kufizimin ose penalizimin e pjesëmarrjes publike, shpesh duke shfrytëzuar një pozitë dominuese pushteti ndaj palës paditëse. [23]

Për të garantuar një mbrojtje efektive, Direktiva parashikon një sërë garancish procedurale. Në mënyrë të veçantë, ajo mundëson rrëzimin në fazë të hershme të procesit të padive qartësisht të pabazuara, [24] duke kaluar barrën e provës tek paditësi. [25] Gjithashtu, gjykatat janë të autorizuar të vendosin sanksione financiare ndaj iniciuesve të padive SLAPP, përfshirë detyrimin për mbulimin e kostove ligjore të të paditurit dhe, kur është e përshtatshme, dhënien e kompensimit për dëmet e pësuar, si edhe sigurimin e mbrojtjes ligjore falas. [26]

Duke qenë se Direktiva zbatohet për çështje me natyrë ndërkufitare, ajo parashikon edhe masa shtesë mbrojtëse në favor të të paditurve. Neni 16 detyron Shtetet Anëtare të refuzojnë njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve që rrjedhin nga procedura qartësisht të pabazuara ose abuzive të ndërmarra në vende të treta. Ndërkohë, neni 17 u njeh juridiksion gjykatave të Shtetit Anëtar ku ka vendbanimin i padituri, për t'i dhënë dëmshpërblim këtij të fundit, në rastet kur procedurat e padisë SLAPP janë iniciuar nga një paditës me vendbanim jashtë Bashkimit Europian, para gjykatave të një vendi të tretë.

Në përfundim, Direktiva Anti-SLAPP krijon një kornizë të harmonizuar minimale për mbrojtjen procedurale të pjesëmarrjes publike në BE, duke vendosur një ekuilibër më të drejtë midis të drejtës për akses në drejtësi [27] dhe nevojës për të parandaluar abuzimin nëpërmjet mekanizmave gjyqësorë.

3.3. Këshilli i Europës dhe paditë SLAPP

Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për kundërshtimin e përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) është një akt i natyrës soft laë i miratuar me qëllim orientimin e shteteve anëtare drejt forcimit të mbrojtjes së lirisë së shprehjes, pjesëmarrjes publike dhe funksionimit demokratik të shoqërisë. Edhe pse nuk ka karakter detyrues juridik, rekomandimi mbart peshë të konsiderueshme normative dhe interpretuese, veçanërisht në lidhje me standardet e nenit 10 të KEDNJ-së dhe jurisprudencën e GjEDNJ-së.

Qëllimi kryesor i këtij akti është të adresojë fenomenin e padive SLAPP si një kërcënim serioz ndaj debatit publik, medias së lirë dhe veprimtarisë së mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Këshilli i Europës evidenton se këto padi nuk synojnë realisht mbrojtjen e reputacionit apo të drejtave subjektive, por përdoren në mënyrë strategjike për të frikësuar, heshtur ose ndëshkuar individë dhe organizata që kontribuojnë në çështje me interes publik, shpesh përmes shfrytëzimit të një çekuilibri të dukshëm pushteti dhe burimesh midis palëve.

Rekomandimi thekson detyrimin pozitiv të shteteve anëtare për të krijuar një mjedis të favorshëm për ushtrimin efektiv të lirisë së shprehjes dhe pjesëmarrjes publike. Në këtë kuadër, ai u bën thirrje shteteve të rishikojnë dhe përmirësojnë kuadrin e tyre ligjor dhe procedural, në mënyrë që gjykatat të jenë në gjendje të identifikojnë dhe ndalojnë në fazat e hershme procedurat qartazi të pabazuara ose abuzive. [28] Një rëndësi e veçantë i kushtohet rolit të gjyqësorit në parandalimin e keqpërdorimit të së drejtës për akses në drejtësi.

Në aspektin e dispozitave substanciale, rekomandimi inkurajon shtetet të parashikojnë mekanizma proceduralë efektivë, si rrëzimi i hershëm i padive SLAPP, rregulla të përshtatshme mbi barrën e provës [29] dhe masa për të kufizuar ngarkesën financiare e psikologjike mbi të paditurit. Ai gjithashtu nënvizon nevojën që shpenzimet gjyqësore dhe dëmshpërblimet të përdoren si instrumente parandaluese ndaj paditësve që veprojnë në mënyrë abuzive, pa cenuar ushtrimin legjitim të të drejtës për t'iu drejtuar gjykatës. [30]

Rekomandimi trajton gjithashtu dimensionin strukturor të problemit, duke vënë theksin te asimetritë e pushtetit dhe ndikimi i tyre në efektin frikësues që paditë SLAPP prodhojnë ndaj debatit publik. Në këtë kontekst, ai i nxit shtetet të marrin masa mbështetëse për gazetarët, aktivistët, organizatat e shoqërisë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut, përfshirë aksesin në asistencë ligjore, [31] trajnime për gjyqtarët dhe profesionistët e drejtësisë, si dhe rritjen e ndërëgjyësimit publik mbi këtë fenomen. [32]

Në përfundim, Rekomandimi i Këshillit të Europës përfaqëson një standard referues europian në luftën kundër padive SLAPP, duke plotësuar dhe forcuar kuadrin e mbrojtjes së ofruar nga KEDNJ-ja. Ai synon të balancojë në mënyrë të kujdesshme të drejtën për akses në drejtësi [33] me nevojën për të parandaluar abuzimin e pushtetit procedural, duke afirmuar se pjesëmarrja publike dhe debati i lirë janë elemente thelbësore të një shoqërie demokratike.

3.4 Sfidat e transpozimit të Direktivës SLAPP në Shtetet Anëtare të BE-së

Pavarësisht se afati përfundimtar i transpozimit të Direktivës (BE) 2024/1069 ishte data 7 maj 2026, ecuria e këtij procesi ndër Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian ka qenë e përshkruar nga ritme dhe zgjidhje legjislative të ndryshme. Deri më tani, vetëm një numër i kufizuar shtetesh, përfshirë Maltën, Rumaninë, Slloveninë, Lituaninë, Francën, Qipro, Finlandën dhe Suedinë kanë miratuar akte përfundimtare transpozimi, [34] ndërsa një grup tjetër shtetesh si Belgjika, Gjermania, Irlanda, Holanda, Polonia, janë akoma në fazën e hartimit të akteve përkatëse. [35]

Kjo asimetri kohore dëshmon qartë vështirësitë teknike dhe politike që sjell harmonizimi i një instrumenti që ndërthur të drejtën e procedurës civile, të drejtën ndërkombëtare private dhe mbrojtjen e të drejtave themelore.

Transpozimi i direktivës është shoqëruar me debate të forta akademike, të cilat kanë evidentuar disa problematika lidhur me mënyrën sesi duhet transpozuar direktiva (mjete juridik) dhe akodomodimi i koncepteve në kontekstet ligjore ekzistuese.

Një sfidë e rëndësishme për transpozimin e direktivës lidhet me zgjedhjen midis hartimit të një ligji të veçantë (*lex specialis*) dhe ndryshimit të kodeve ekzistuese të procedurës civile. Për shembull Lituania, e ka transpozuar Direktivën përmes ndërhyrjeve të drejtpërdrejta në Kodin e Procedurës Civile dhe në ligjin që rregullon zbatimin e instrumenteve të BE-së, duke parashikuar një procedurë të përsheptuar mbi themelin, e cila zbatohet si për çështjet e brendshme ashtu edhe për ato ndërkufitare. Megjithatë, ky model kërkon që viktimi e padisë SLAPP t'i nënshtrohet gjykimit të plotë mbi themelin, duke hequr mundësinë e rrëzimit të padisë në fazë përgatitore, e cila ekzistonte në legjislacionin e mëparshëm kombëtar të vitit 2022, duke ngritur kështu kritika lidhur me uljen e nivelit të mbrojtjes për të paditurit në raste qartazi abuzive. Sllovenia, në janar të vitit 2026, ka miratuar një ligj të veçantë mbi masat mbrojtëse në lidhje me paditë SLAPP, i cili ofron rrëzim të hershëm të padive haptazi të pabazuara, sigurim të shpenzimeve të të paditurit, rimbursim të plotë të kostove, sanksion monetar dhe kompensim, duke shkuar përtej kërkesave minimale të Direktivës.

Polonia, nga ana e saj, ka propozuar formën e një statuti të ndarë nga Kodi i Procedurës Civile, gjë që sipas studiuesve ka ngritur shqetësime për koherencën e brendshme të sistemit procedural. [36]

Nga pikëpamja krahasuese, mund të identifikohen disa sfida të transpozimit të standardeve të Direktivës në Shtetet Anëtare. Së pari, mungesa e një nocioni të vetëm europian për “procedurat haptazi të pabazuara” lë hapësirë për interpretime kombëtare të ndryshme, të cilat mund të çënojnë sigurinë juridike në rastet me element ndërkufitar. Së dyti, marrëdhënia midis dispozitave të reja anti-SLAPP dhe klauzolës tradicionale të rendit publik mbetet e patrajtuar qartë, duke krijuar mbivendosje dhe paqartësi për gjykatat. Së treti, vendimi i disa shteteve për të mos kodifikuar treguesit e procedurave abuzive të parashikuar në nenin 4 të Direktivës, për shembull në rastin holandez, mund të ulë kapacitetin e gjyqtarëve për të identifikuar shpejt një padi SLAPP. Së katërti, shumëllojshmëria e qasjeve ndaj garancive procedurale plotësuese, sigurimi për shpenzimet, kufijtë maksimalë të dëmshpërblimit, sanksionet, ndihma juridike falas, krijon një nivel të pabarabartë mbrojtjeje në të gjithë territorin e Bashkimit Europian.

Problematika shfaqen edhe në transpozimin e neneve 16 dhe 17 të cilat lidhen me raportet me vendet e treta. Neni 16 Direktivës, rregullon refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të vendeve të treta të dhëna në procedura SLAPP.

Ndërsa neni 17 cili u njeh juridiksion gjykatave të Shtetit Anëtar ku ka vendbanimin i padituri për ta dëmshpërblyer atë për dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara nga procedurat SLAPP të iniciuara në vende të treta.

Shtetet i kanë adresuar këto nene në mënyra të ndryshme. Në njërin anë, shtete si Malta dhe

Rumania kanë zgjedhur një dispozitë të posacme që parashikon shprehimisht refuzimin e njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të huaja kur procedurat në vendet e treta vlerësohen si haptazi të pabazuara ose abuzive. Në anën tjetër, Gjermania, Polonia, Holanda dhe Suedia kanë vlerësuar se klauzola e përgjithshme e rendit publik është e mjaftueshme për të përmbushur objektivat e nenit 16. [37] Diskutimet akademike kanë vënë në dukje se mbështetja vetëm tek klauzola e rendit publik krijon një pasiguri të dyfishtë duke dëmtuar koherencën e sistemit evropian të mbrojtjes nga paditë SLAPP me element ndërkuftar.[38]

Lidhur me nenin 17 të Direktivës, shumica e shteteve kanë zgjedhur të parashikojnë një dispozitë të shprehur, megjithëse me ndryshime të dukshme përsa i përket fushës së zbatimit dhe kushteve. Për shembull, akti maltez [39] transponon nenin 17 nëpërmjet një dispozite të veçantë që lejon viktimën e një padie SLAPP me vendbanim në Maltë të kërkojë dëmshpërblim para gjykatave malteze, por e bën këtë të varur nga përfundimi i procedurave në vendin e tretë, gjë që mund të ulë efektivitetin praktik të mjetit. Projektligji polak parashikon juridiksion vetëm kur i padituri ka vendbanimin në Poloni dhe procedurat e iniciuara jashtë BE-së për procedura që kanë pasur si qëllim kryesor parandalimin ose ngacmimin e debatit publik. [40]

Këto analiza krahasimore janë të rëndësishme për Shqipërinë në dy drejtime. Në aspektin pozitiv, përvoja e shteteve si Lituania, Sllovenia dhe Malta tregon se në legjislacionet kombëtare mund të ofrojë, që në fillim, një mbrojtje më e gjerë se ajo që kërkohet shprehimisht nga Direktiva, veçanërisht duke zbatuar regjimin anti-SLAPP edhe ndaj çështjeve thjesht të brendshme dhe duke parashikuar mekanizma të rrëzimit të hershëm. Në aspektin parandalues, duhet të mbahen parasysh problemet e identifikuara në transpozimet e BE-së: domosdoshmërinë e një dispozite të shprehur për refuzimin e njohjes së vendimeve abuzive nga vendet e treta, përcaktimin e qartë të treguesve të padive SLAPP, ndarjen e qartë midis klauzolës së rendit publik dhe bazave të reja të refuzimit, si dhe formësimin e kuptueshëm të nocionit të “procedurave haptazi të pabazuara” në pajtim me jurisprudencën e GjEDNJ-së dhe me objektivat e Direktivës.

Transpozimi i Direktivës dhe Rekomandimeve të KiE

4.1 Kuadri normativ ekzistues dhe boshllëqet

Në kuadër të proceseve integruese, Shqipëria ka marrë angazhimin të bëjë pjesë të legjislacionit të saj standardet evropiane që lidhen me paditë SLAPP. [41] Ndryshimet ligjore do të ofrojnë garanci shtesë, pasi gjykatat kombëtare janë të detyruara të zbatojnë dhe të ndjekin jurisprudencën e gjykatave evropiane, veçanërisht të GjEDNJ [42] sa herë që kufizojnë lirinë e shprehjes.

Shqipëria ka një kornizë ligjore për mbrojtjen e fjalës së lirë, por ka akoma punë për të mbrojtur gazetarët. [43] Rastet e frikësimit dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, dhe veçanërisht gazetarëve investigativë nga zyrtarë të lartë, mbeten një shqetësim. Një nga sfidat e mbrojtjes së fjalës së lirë mbetet dekriminalizimi i veprave penale të fyerjes dhe shpifjes [44], lehtësimi i masave të dënimit [45] dhe dekriminalizimi i pjesëshëm i veprës penale të shpifjes së gazetarëve. [46] Sipas ndryshimeve të fundit të Kodit Penal gazetarët zhvishen nga përgjegjësia penale nëse zbatohen në mënyrë kumulative disa kushte: (1) subjekti duhet të jetë gazetar i punësuar ose i vetëpunësuar, i regjistruar dhe i njohur si i tillë, pra mbrojtja nuk shtrihet te aktivistët, studiuesit, denoncuesit apo qytetarët e thjeshtë; (2) informacioni duhet të jetë përhapur në mirëbesim dhe në përputhje me rregullat etike e profesionale, mbi baza faktike të arsyeshme, me qëllim informimin e publikut për çështje me interes të përgjithshëm; (3) gazetari nuk duhet të ketë qenë në dijeni se informacioni ishte i rremë, duhet të ketë bërë përpjekje të arsyeshme për verifikimin e saktësisë, dhe, sapo të njoftohet për pasaktësinë, duhet të veprojë pa vonesë për ta përgënjeshtuar ose hequr atë.[47] Ndryshimet përcaktojnë gjithashtu se:

“përhapje me mirëbesim” sipas (nenit 120) do të thotë përhapje që plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin e tretë të këtij neni dhe kryhet në përputhje me rregullat etike e profesionale të gazetarisë, mbi baza faktike e të arsyeshme. Vlerësimet, opinionet, komentet, kritikët ose interpretimet, edhe kur janë therëse, të ekzagjeruara ose fyese, nuk konsiderohen shpifje në kuptim të këtij neni, përveç nëse përmbajnë, shprehimisht ose të nënkuptuara pretendime, fakte, të dhëna apo informacione objektivisht të rreme”. [48]

Nga ana tjetër kuadri normative ekzistues përfshin disa ligje të tjera që janë të lidhura me këto padi, duke filluar që nga Kodi i Procedurës Civile, ligji për të drejtën ndërkombëtare private apo ligji për ndihmën juridike falas. Secili më vete ofron disa garanci, por pa specifikuar se ato mund të përdoren në rastet e padive SLAPP.

Kështu Kodi i Procedurës Civile, ka një dispozitë të posaçme për të adresuar “paditë abuzive”, të cilat synojnë luftimin e taktikave zvarritëse dhe sjelljes abuzive në sistemin gjyqësor. Nëse palët ose përfaqësuesit e tyre paraqesin kërkesa të përsëritura ose me dashakeqësi, shtrembërojnë faktet ose zgjasin me qëllim procedurat, mund të vendosen gjopa kundrejt tyre. Gjopa mund të vendosen edhe ex officio nga gjykata nëse palët paraqesin kërkesa abuzive për përjashtimin e gjyqtarëve gjithashtu, nëse pa shkak të arsyeshëm, shkaktojnë vonesa në shqyrtimin e çështjeve. [49]

Kodi i Procedurës Civile e vendos barrën e provës mbi palën që paraqet padinë, që do të thotë se ajo duhet të paraqesë prova për të mbështetur çështjen e saj.[50] Një studim i çështjeve të shpifjes (2016–2021) tregon se të paditurit mbajnë barrën e provës dhe nuk ka një përmbysje të kësaj barre. [51]

E drejta për të kërkuar kompensim për dëme që vijnë nga cenimi i personalitetit garantohet si nga ligji civil ashtu edhe nga ai penal. Neni 59 i Kodit të Procedurës Penale parashikon të drejtën e personit të dëmtuar nga një vepër penale [52] të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.

Po kështu sipas nenit 617 të Kodit Civil, publikimi i përgënjeshtimit përbën një formë të rivendosjes së të drejtave të palës së dëmtuar nga publikime mashtruese ose të pasakta. Ndërkohë, kriteret e caktimit të masës së dëmshpërblimit, të parashikuara nga neni 647/a i Kodit Civil, duhet të zbatohen duke pasur parasysh ruajtjen e një balance proporcionale midis dëmit të pësuar dhe mosrëndimit të gjendjes financiare të shkaktarit të dëmit. [53]

Kodi i Procedurës civile rregullon edhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të gjykatave të huaja. Brenda kushteve të refuzimit përfshihet dhe rendi publik. [54] Ndërkohë që ligji për të drejtën ndërkombëtare private rregullon juridiksionin e gjykatave në ceshtjet me elementë të huaj. [55]

Sipas ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", garantohet dhe nidhma juridike falas për personat që plotësojnë kriteret e parashikuara në këtë ligj, me qëllim sigurimin e aksesit të barabartë në drejtësi, veçanërisht për kategoritë në nevojë dhe grupet vulnerabël. Ky ligj nuk parashikon ndihmë juridike për viktimat e padive SLAPP.

Përpos kësaj ekspozije, kuadri normativ ekzistues mbetet i pamfjaftueshëm për mbrojtjen e padive SLAPP. Kjo evidentohet edhe nga Komisioni European i cili ka identifikuar mungesën e masave mbrojtëse efektive kundër padive SLAPP si një problem serioz që cenon lirinë e shprehjes, pluralizmin e medias dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile. [56]

4.2. Rrugët e mundshme të transpozimit dhe kriteret e një ligji efektiv

Transpozimi dhe zbatimi i standardeve europiane kundër padive SLAPP mund të arrihet përmes miratimit të ligjeve të posaçme Anti-SLAPP [57] si *lex specialis*, dhe/ose përmes ndryshimeve në ligje të ndryshme ekzistuese, me qëllim që garancitë procedurale dhe mjetet juridike të parashikuara në instrumentet Anti-SLAPP të Këshillit të Europës dhe të BE-së të përfshihen në të drejtën e brendshme.[58]

Rekomandohet që autoritetet shqiptare të adoptojnë një qasje gjithëpërfshirëse, duke ndryshuar si Kodet, si legjislacion bazë, si dhe duke miratuar një ligj të posaçëm kundër padive SLAPP. Ky kombinim është i rëndësishëm për shkak të rolit mbizotërues të rregullave të Kodeve në praktikë. Përmes ndryshimeve në këto dy akte ligjore, do të vendoseshin në të drejtën e brendshme garanci procedurale thelbësore kundër padive SLAPP, në përputhje me standardet europiane: tregues për identifikimin e padive SLAPP, mekanizma për rrëzimin e hershëm të tyre përfshirë afatet kohore dhe barrën e provës, sigurimin e shpenzimeve procedurale, rimbursimin e kostove ligjore, si dhe pezullimin e procedimit.

Nga ana tjetër, ligji i posaçëm kundër padive SLAPP do të përfshinte aspekte që nuk gjejnë vend natyreshëm në kodet bazë, sic është përfshirja e koncepteve bazë, njohja e statusit të viktimës së padive SLAPP, kompensimi për dëmet e pësuar, mbrojtje ligjore ose vendosja e kufijve maksimalë për dëmet që mund t'i kërkojnë paditësit, si edhe adresimi i çështje me natyrë ndërkufitare.

Përfundime dhe Rekomandime

Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) përfaqësojnë një nga sfidat më serioze bashkëkohore për lirinë e shprehjes, pluralizmin e medias dhe pjesëmarrjen qytetare në një shoqëri demokratike. Karakteri i tyre i veçantë qëndron jo te ushtrimi legjitim i së drejtës për akses në drejtësi, por te keqpërdorimi i instrumenteve procedurale me qëllim intimidimin, heshtjen ose ngarkimin financiar dhe psikologjik të gazetarëve, aktivistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut. Përgjigjja e Bashkimit Europian, e konkretizuar në Direktivën (BE) 2024/1069 dhe e plotësuar nga Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Këshillit të Europës, përbën një kthesë të rëndësishme normative, e cila krijon për herë të parë një kornizë minimale procedurale të harmonizuar në nivel europian.

Megjithatë, përvoja e Shteteve Anëtare të BE-së në transpozimin e Direktivës tregon se kalimi nga standardet europiane në të drejtën e brendshme nuk është një proces thjesht teknik. Përkundrazi, ai kërkon zgjidhje të ndjeshme për pyetje themelore, siç janë: raporti midis dispozitave të reja anti-SLAPP dhe klauzolës tradicionale të rendit publik, kufijtë e nocionit të “procedurave haptazi të pabazuara”, mjetet konkrete për rrëzimin e hershëm të padive abuzive, si dhe garancitë e juridiksionit në rastet me element ndërkufitar. Mungesa e një qasjeje të njëjtë në nivel europian dëshmon se Direktiva ofron vetëm një standard minimal, të cilin shtetet kanë lirinë ta forcojnë më tej.

Për Shqipërinë, në cilësinë e një vendi kandidat me anëtarësi të pritshme në BE, këto zhvillime kanë një rëndësi të dyfishtë.

Në rrafshin formal, përafrimi i legjislacionit me Direktivën nuk është vetëm një angazhim i marrë në kuadër të negociatave të anëtarësimit, por edhe një mjet konkret për forcimin e shtetit të së drejtës. Në rrafshin material, kuadri ligjor ekzistues ofron mjete të cilat nuk u përgjigjen plotësisht specifikave të padive SLAPP. Mungesa e dekriminalizimit të plotë të shpifjes dhe mungesa e një mekanizmi për rrëzimin e hershëm të padive haptazi të pabazuara dëshmojnë se reformimi i kuadrit kombëtar përbën një nevojë të ngutshme.

Në këtë kontekst, rekomandohet një qasje e përbërë që ndërthur tre nivele veprimi.

Së pari, në nivelin legjislativ, miratimi i një ligji të veçantë anti-SLAPP si *lex specialis*, krahas ndryshimeve të nevojshme në Kodet procedurale. Këto dispozita duhet të parashikojnë tregues të qartë të padive SLAPP, mekanizma të rrëzimit të hershëm me afate të arsyeshme, sigurimin e shpenzimeve të të paditurit, kompensim për dëmet dhe sanksione të përshtatshme për paditësin abuziv, në pajtim me garancitë e nenit 6 të KEDNJ-së.

Së dyti, në nivelin institucional, është e nevojshme rritja e kapaciteteve të gjyqësorit nëpërmjet trajnimeve të veçanta për gjyqtarët dhe profesionistët e drejtësisë mbi standardet anti-SLAPP, jurisprudencën e GjEDNJ-së dhe përvojat krahasuese të Shteteve Anëtare.

Së treti, në nivelin shoqëror, është thelbësore garantimi i ndihmës juridike falas për viktimat e padive SLAPP, mbështetja e organizatave të shoqërisë civile që mbrojnë gazetarët dhe aktivistët, si dhe rritja e ndërgjegjësimit publik mbi natyrën abuzive të këtyre padive.

Në përfundim, lufta kundër padive SLAPP nuk është thjesht një çështje teknike e procedurës civile apo penale, por një provë e seriozitetit me të cilin një shoqëri demokratike mbron lirinë e shprehjes, pluralizmin e medias dhe pjesëmarrjen publike. Për Shqipërinë, transpozimi i Direktivës dhe Rekomandimeve të KiE përbën një mundësi jo vetëm për përmbushjen e detyrimeve në rrugën e integritit evropian, por edhe për ndërtimin e një mjedisi ligjor që mbron dinjitetin e debatit publik dhe garanton se zëri i gazetarëve, aktivistëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut nuk do të mund të heshtet nëpërmjet mjeteve gjyqësore. Mësimet e nxjerra nga përvojat e ndryshme të transpozimit në Shtetet Anëtare ofrojnë një bazë të vlefshme për të ndërtuar në Shqipëri një kuadër ligjor të integruar, koherent dhe në përputhje me standardet europiane.

[1] Shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, GjEDNJ, vendim i 7 dhjetorit 1976, par. 49; dhe Lingens kundër Austrisë, GjEDNJ, vendim i 8 korrikut 1986, par. 42, ku Gjykata pranoi se kufijtë e kritikës së lejueshme janë më të gjerë kur ajo i drejtohet politikanëve dhe bartësve të funksioneve publike sesa individëve privatë.

[2] Termi u prezantua fillimisht nga George W. Pring dhe Penelope Canan. Shih George W. Pring, SLAPPs: Strategic Lawsuits Against Public Participation, 7 Pace Environmental Law Review 3 (1989); dhe George W. Pring & Penelope Canan, SLAPPs: Getting Sued for Speaking Out, Temple University Press, Philadelphia, 1996.

[3] Për natyrën instrumentale dhe "ndëshkuese" të procesit në vend të rezultatit gjyqësor, shih Petra Bárd, Judit Bayer, Ngo Chun Luk & Lina Vosyliūtė, Ad-Hoc Request: SLAPP in the EU Context, EU-CITIZEN – Academic Network on European Citizenship Rights, Komisioni Europian, 29 maj 2020.

[4] Mbi rolin e kësaj ngjarjeje si katalizator i veprimit evropian, shih Judit Bayer, Petra Bárd, Lina Vosyliūtė & Ngo Chun Luk, Strategic Lawsuits Against Public Participation (SLAPP) in the European Union: A Comparative Study, Komisioni Europian, 2021; si dhe raportin e Koalicionit kundër SLAPP-ve në Europë (CASE), Shutting Out Criticism: How SLAPPs Threaten European Democracy, mars 2022.

[5] Për herë të parë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës u formësua koncepti dhe terminologjia për paditë SLAPP. Hulumtimi i parë sistematik mbi paditë SLAPP u krye në vitet 1970 nga studiuesit Penelope Canan dhe George W. Pring, të cilët realizuan një studim empirik mbi 228 çështje të klasifikuara si padi SLAPP. Për më shumë shih: Pring, G.W., SLAPPs: Strategic Lawsuits against Public Participation, Pace Environmental Law Review, Vol. 7, Issue 1, 1989.

[6] Direktiva (BE) 2024/1069 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, e datës 11 prill 2024, për mbrojtjen e personave që angazhohen në pjesëmarrje publike nga paditë haptazi të pabazuara ose procedurat gjyqësore abuzive ("Paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike" – SLAPP), OJ L, 2024/1069, 16.4.2024, ELI: <http://data.europa.eu/eli/dir/2024/1069/oj>.

[7] Rekomandimi CM/Rec(2024)2 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës drejtuar shteteve anëtare për luftimin e përdorimit të padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP), miratuar më 5 prill 2024. Shih edhe Rekomandimin 2267 (2024) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, Countering SLAPPs: an imperative for a democratic society, 25 janar 2024.

[8] Shih EU Common Position for Albania Cluster 1 Fundamentals AD 13/26, pg.14 <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2026/05/26/enlargement-albania-meets-interim-benchmarks-for-fundamentals-cluster/>

[9] Shih përkufizimet e Rekomandimit CM/Rec(2024)2 të Komitetit të Ministrave drejtuar Shteteve Anëtare për të luftuar përdorimin e Padive Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike (SLAPP).

[10] Po aty.

[11] Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar në Romë më 4 nëntor 1950, hyrë në fuqi më 3 shtator 1953, neni 10.

[12] Mbi rolin e shtypit si "qen roje publik" (public watchdog) i demokracisë, shih ndër të tjera: Observer dhe Guardian k. Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, kërkesa nr. 13585/88, vendim i datës 26 nëntor 1991, § 59

[13] Handyside k. Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, kërkesa nr. 5493/72, vendim i datës 7 dhjetor 1976, § 49.

[14] Lingens k. Austrisë, GJEDNJ, kërkesa nr. 9815/82, vendim i datës 8 korrik 1986, § 42.

[15] Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, FZ e Bashkimit Evropian, C 326, 26 tetor 2012, fq. 391-407

[16] Google Spain SL dhe Google Inc. k. Agencia Española de Protección de Datos (AEPD) dhe Mario Costeja González, C-131/12, vendim i datës 13 maj 2014, ECLI:EU:C:2014:517.

[17] Eva Glawischnig-Piesczek k. Facebook Ireland Limited, C-18/18, vendim i datës 3 tetor 2019, ECLI:EU:C:2019:821.

[18] OOO Memo k. Ruisisë, GJEDNJ (Seksioni i Tretë), kërkesa nr. 2840/10, vendim i datës 15 mars 2022, [2022] ECHR 229

[19] GJDBE (Dhoma e Madhe), Real Madrid Club de Fútbol dhe AE k. EE dhe Société Éditrice du Monde SA, C-633/22, vendim i datës 4 tetor 2024, ECLI:EU:C:2024:843. Vendimi u dha si përgjigje ndërmjet një kërkesë për vendim paraprak nga Gjykata e Kasacionit franceze dhe nuk përbën zgjidhje përfundimtare të çështjes, por udhëzon gjykatën kombëtare se ekzekutimi mund të refuzohet mbi bazën e përjashtimit të rendit publik (neni 34(1) i Rregullores (KE) nr. 44/2001 "Bruksel I")

[20] Rregullorja (BE) Nr. 1215/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 dhjetor 2012, mbi juridiksionin dhe njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve në çështjet civile dhe tregtare (e rishkuar).

[21] Direktiva (BE) 2024/1069 supra note 6.

[22] Neni 1 Direktivës Anti-SLAPP

[23] Neni 4 i Direktivës Anti-SLAPP.

[24] Neni 11 i Direktivës Anti-SLAPP.

[25] Neni 12 i Direktivës Anti-SLAPP.

[26] Neni 10 i Direktivës Anti-SLAPP.

[27] Shih nenin 47 të Kartës së BE-së.

[28] Pikat 21–23 të Rekomandimit CM/Rec(2024)2.

[29] Pikat 25–34 të Rekomandimit CM/Rec(2024)2.

[30] Pika 37 e Rekomandimit CM/Rec(2024)2.

[31] Pikat 50–56 të Rekomandimit CM/Rec(2024)2.

[32] Pika 57 e Rekomandimit CM/Rec(2024)2.

[33] Neni 6(1) i KEDNJ-së.

[34] <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/NIM/?uri=CELEX:32024L1069>

[35] Shih: B. van Houtert dhe M. Pasqua, Second Meeting of the EAPIL Working Group on Anti-SLAPP Directive Transpositions – Report (Part I), EAPIL Blog, 27 nëntor 2025, <https://eapil.org/2025/11/27/second-meeting-of-the-eapil-working-group-on-anti-slapp-directive-transpositions-report-part-i/>.

[36] Shih: A. Doržinkevič dhe A. Kiknadze, Transposition of Anti-SLAPP Directive in Lithuania, EAPIL Blog, 20 mars 2026; J. Kramberger Škerl, Slovenia Adopts Anti-SLAPP Legislation, EAPIL Blog, 18 shkurt 2026, <https://eapil.org/2026/02/18/slovenia-adopts-anti-slapp-legislation/>.

[37] Shih: B. van Houtert dhe M. Pasqua, Second Meeting of the EAPIL Working Group on Anti-SLAPP Directive Transpositions – Report (Part II), EAPIL Blog, 28 nëntor 2025, <https://eapil.org/2025/11/28/second-meeting-of-the-eapil-working-group-on-anti-slapp-directive-transpositions-report-part-ii/>.

[38] Po aty.

[39] L.N. 177/2024

[40] Po aty. Për raporte të ngjashme mbi transpozimet kombëtare, shih edhe: A. Doržinkevič dhe A. Kiknadze, Transposition of Anti-SLAPP Directive in Lithuania: Key Procedural Changes and Challenges, EAPIL Blog, 20 mars 2026, <https://eapil.org/2026/03/20/transposition-of-anti-slapp-directive-in-lithuania-key-procedural-changes-and-challenges/>.

[41] Shqipëria ka kryer Konferencën Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit në korrik 2022 dhe ka hapur të gjithë grupkapitujt e negociatave. Për më shumë shih: https://enlargement.ec.europa.eu/countries/albania_en.

[42] Këshilli i Europës, Udhëzues për nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, 2022, f. 18, <https://rm.coe.int/guide-on-article-10-freedom-of-expression-alb/native/1680ad61d7>.

[43] Komisioni Evropian, Albania 2025 Report, f. 36.

[44] Nenet 239-241 të Kodit Penal Ligji nr. 23/2012.

[45] Nenet 119-120 të Kodit Penal Ligji nr. 23/2012

[46] Neni 120 i Kodit Penal ndryshuar me Ligjin nr. 8/2026, date 28.1.2026, FZ nr.36/2026

[47] Neni 17 qe ndryshon nenin 120/2, ibid

[48] Neni 17 qe ndryshon nenin 120/2, ibid

[49] Shih nenet 34, 76 dhe 107 te ligjit nr. 8116, date 29.03.1996 "Kodi i Procedures Civile i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.

[50] Nenet 12 dhe 31 te Kodit te Procedures Civile.

[51] Res Publica, Studimi Liria e Shprehjes dhe Jurisprudenca e GJEDNJ ne praktiken vendase, 2022, f. 114-117, <https://rm.coe.int/studimiliria-e-shprehjes-dhe-jurisprudenca-e-gjednj-ne-praktiken-venda/1680a8982f>.

[52] Sic jane vepra penale e fyerjes, neni 119, fyerja me motive racizmi ose ksenofobie nepermjet sistemit kompjuterik, neni 119/b, dhe shpifja, neni 120, i Kodit Penal.

[53] Ligji nr. 7850, date 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar.

[54] Neni 394/dh parashikon se Vendimit te nje gjykate te shtetit te huaj nuk i jepet fuqi ne Republikën e Shqiperise kur: dh) nuk pajtohet me parimet baze te legjislacionit shqiptar e lexuar si e vleshme per rendin public.

[55] Ligji nr. 10428, date 2.6.2011 "Per te drejten nderkombetare private".

[56] Ibid.

[57] Keshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 787, date 18.12.2024 "Per miratimin e strategjise ndersektoriale te drejtesise 2024-2030", vendimin nr. 91, date 12.02.2025 "Per miratimin e dokumentit te politikave prioritare 2026-2028", te ndryshuar, dhe vendimin nr. 736, date 13.12.2023 "Per miratimin e udhirrefyesit per shtetin e se drejtes", ku ka parashikuar parafrimin e legjislacionit vendas me Direktiven Anti-SLAPP.

[58] Keshilli i Europes, Regional Baseline Assessment of Legislative and Policy Needs for Implementing Council of Europe and European Union Standards on Countering the Use of SLAPPs, 2024, <https://rm.coe.int/regional-baseline-assessment-of-legislative-and-policy-needs-for-imple/1680b2e38f>.